

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qeveria miraton projektligjin për rezervat e naftës dhe nënprodukteve të saj, administrator do të jetë shtë ti! Sasia që do të ruhet, e barazvlefshme me 3 muaj konsum të brendshëm - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/qeveria-miraton-projektligjin-per-rezervat-e-naftes-dhe-nenprodukteve-te-saj-administrator-do-te-jete-shteti-sasia-qe-do-te-ruhet-e-barazvlefshme-me-3-muaj-konsum-te-brendshem
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 19:19:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 19:15:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6905e624464c75c31d4aea5f8d0c1db0bbd07e8b4200ebc3b40d591990d4e33d
TEKSTI	463e8aa85e104d339b05b80d6e2b193c83ef5d487d9262214ae935d7c749f472
PAMJA	01c31a55641cd607dd8bc5e7de89c973c47e08a3183a67a292651535adfa35a8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	147cf65c7773e4a649c74d45ee9dd5239bc7f11b3e9c98b3914f9db556a5e799
E MËPARSHMJA	85f0eae17207b70e05c19cc6aace4dff096f6d37aa7871008ba57d4de996aab9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/147cf65c7773e4a649c74d45ee9dd5239bc7f11b3e9c98b3914f9db556a5e799>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Carlo Bollino: Ja ku gjenjen Berisha mbi agjentin e FBI, dhe pse as në 11 shkurt nuk do ketë asnjë "uragan popullor" kundër Edi Ramës

Politikë

Qeveria miraton projektligjin për rezervat e naftës dhe nënprodukteve të saj, administrator do të jetë shteti! Sasia që do të ruhet, e barazvlefshme me 3 muaj konsum të brendshëm

Për krijimin dhe menaxhimin e këtyre rezervave parashikohet ngritja e Autoritetit për Rezervën e Sigurisë së Naftës, një ent publik në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë. Autoriteti do të ketë kompetencë për blerjen, shitjen, depozitimin dhe vënien në qarkullim të rezervave të sigurisë, vetë ose përmes operatorëve ekonomikë.

■ Çmimi i lartë i naftës, qeveria rikthen Bordin e Transparencës dhe uljen 20% të akcizës!



Foto ilustruese



Redaksia

16 Shtator, 21:13 | Përditësimi: 16 Shtator, 21:20

Share Tweet

A A

Qeveria ka propozuar krijimin e një sistemi të ri për krijimin, administrimin dhe përdorimin e rezervave minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Shqipëri.

Projektligji i miratuar sot në mbledhjen e Këshillit të Ministrave synon të garantojë sigurinë e furnizimit me karburante dhe përafrimin e rregullave shqiptare me standardet e Bashkimit Evropian.

Sipas projektligjit, Shqipëria duhet të krijojë gradualisht rezerva të barasvlefshme me të paktën 90 ditë të importeve neto ose 61 ditë të konsumit të brendshëm, duke marrë si referencë sasinë më të madhe.



LEXO EDHE:

Ylli Pata: Flamingot çfarë janë sot, lëvizje apo revolucion?

Për krijimin dhe menaxhimin e këtyre rezervave parashikohet ngritja e Autoritetit për Rezervën e Sigurisë së Naftës, një ent publik në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë. Autoriteti do të ketë kompetencë për blerjen, shitjen, depozitimin dhe vënien në qarkullim të rezervave të sigurisë, vetë ose përmes operatorëve ekonomikë.



Rezervat mund të depozitohen edhe nga operatorë ekonomikë të autorizuar përmes marrëveshjeve kontraktore me Autoritetin. Operatorët do të jenë përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, sigurinë fizike dhe cilësinë e rezervave që mbajnë në depozitat e tyre.

Projektligji parashikon gjithashtu krijimin e rezervave specifike për produkte të caktuara, mes tyre benzina, gazoli, karburantet e avionit, gazi i lëngëzuar i naftës, mazuti, vajrat lubrifikante dhe bitumi.

Financimi i sistemit do të bëhet përmes disa burimeve, ku përfshihet një tarifë e posaçme për krijimin dhe mbajtjen e rezervës së sigurisë.

Kjo tarifë do të aplikohet mbi produktet energjetike hidrokarbure që i nënshtrohen akcizës, përfshirë edhe karburantin e avionit. Nivelin e tarifës do ta përcaktojë Këshilli i Ministrave, ndërsa shuma do të lidhet me nevojat e financimit të rezervave për çdo vit fiskal.

Në rast të ndërprerjes së furnizimit ose të një rritjeje të ndjeshme të çmimeve në tregun ndërkombëtar, Këshilli i Ministrave mund të vendosë përdorimin e rezervave të sigurisë. Përdorimi i tyre do të bëhet sipas një Plani Kombëtar të Reagimit, i cili do të përcaktojë arsyet, sasitë, afatet dhe kushtet e nxjerrjes së rezervave në treg.

Projektligji parashikon edhe një Regjistër Kombëtar të Rezervave të Sigurisë, ndërsa të dhënat e detajuara për vendndodhjen dhe strukturën e tyre do të trajtohen si konfidenciale. Për shkeljet e detyrimeve parashikohen gjoba nga 2 milionë deri në 10 milionë lekë dhe, në rast përsëritjeje, edhe ndalim i përkohshëm i aktivitetit për depozitim të rezervave.

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: [qeveria](#) [qeveria shqiptare](#) [rezervat e naftës](#) [nafta](#) [çmimi i naftës](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?



3.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Hamdi Jupe: Leximi i numrave ose, mjerim opozitar!



Hamdi Jupe

20 Shtator, 15:41



Minella Aleksi: Pushteti e pret protestën si një serial televiziv, në të njëjtën orë, në të njëjtin vend, me të njëjtin repertor



Minella Aleksi

20 Shtator, 15:03



Shteti 90 ditë naftë rezervë në rast krize! Do krijohet me një tarifë të re që rrezikon rritjen e çmimit për konsumatorët



Eliza Gjedik

19 Shtator, 12:24



Adrian Thano: Sa më shumë korrupsion, aq më pak sovranitet



Adrian Thano

18 Shtator, 21:14



Ylli Pata: 84 votat e mazhorancës si sinjal politik për sponsorët e flamingove



Ylli Pata

18 Shtator, 18:17



Çmimi i lartë i naftës, hyn në fuqi vendimi për rikthimin e Bordit të Transparencës! Pritet edhe ulja me 20% të akcizës!

17 Shtator, 15:47



Kuvend/ Pagat e magjistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Bardhi: Puç kushtetues, votojmë kundër! Malaj: Si u kërcënuan punonjësit e Thesarit nga prokurori

17 Shtator, 07:57



VKM/ Mario Keputa emërohet zv.ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit

16 Shtator, 21:23



Preç Zogaj: Në Shqipërinë e sotme 'revolucionit' ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë



Preç Zogaj

15 Shtator, 21:44



Zv/Ndihmës Sekretari amerikan i Shtetit: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale dhe për të zgjeruar qasjen e kompanive të SHBA në treg

15 Shtator, 16:27



Çmimi i naftës, PD: Qeveria të ndërhyjë, të 'zhveshë' dieselin nga barrat fiskale (VIDEO)

15 Shtator, 11:35



Ngërçi i pagave/ Avokati Çela: Qeveria asnjëherë nuk u ka dhënë magjistratëve atë që është përcaktuar me ligj! Fociro: Rama po ushtron presion ndaj drejtësisë, kërkon ta vërë nën kontroll (VIDEO)

14 Shtator, 17:58

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.